



**UDHËZUES PËR
ORGANIZATAT
JO-FITIMPRURËSE
SHQIPTARE**



WWW.GLOBALALBANIANS.ORG

UDHËZUES PËR ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE SHQIPTARE

Janar 2021

Përmbledhje

Fondacioni Global Shqiptar (FGSH) u themelua për të ndihmuar organizatat jofitimprurëse shqiptare të mbledhin para për organizimet dhe projektet e tyre. Kjo është ajo që ne bëjmë. Ne duam që ju të arrini shqiptarët dhe albanofilët kudo në botë për të mbështetur përpjekjet tuaja dhe për të realizuar ëndrrat tuaja. Ne do t'ju ndihmojmë ta bëni këtë përmes mbledhjes së fondeve në internet dhe crowdfunding.

Duke përdorur platformën GAF ne mendojmë se shumë organizata shqiptare mund të mbledhin mijëra dollarë nga qindra donatorë të vegjël dhe të mesëm. Ne kryesisht përdorim Facebook-un dhe faqen e internetit të GAF për mbledhje të fondeve. Facebook është një platformë e fuqishme për mbledhjen e parave publike pasi të gjithë mund të shohin se sa mjete janë grumbulluar dhe kush ka dhuruar, ndërsa faqja jonë e internetit është në dispozicion për ata që preferojnë të mos dhurojnë përmes Facebook.

Megjithatë gjëja më e rëndësishme është që ju të kontaktoni dhe arrini sa më gjerësisht me Komunitetin Global Shqiptar. Ju duhet të promovoni dhe tregtoni organizatën tuaj dhe punën e saj duke përdorur GAF, Facebook dhe platforma të tjera të mediave sociale. Donatorët nuk do të vijnë tek ju - ju duhet të shkoni tek ata.

Miratimi i kërkesës suaj për ngritje të fondeve online

1. Hapi i parë në këtë proces është plotësimi i [formës e aplikimit](#) për të përdorur platformën e GAF;
2. Nëse fushata e mbledhjes së fondeve tuaja miratohet, atëherë do t'ju kërkohet të nënshkruani një kontratë;
3. Çfarëdo pyetje që ju mund të keni në lidhje me këtë proces, ju mund të drejtoheni tek: grants@globalalbanians.org.

Krijimi i fushatës për mbledhje të fondeve online

1. Pasi të miratohet fushata e juaj e mbledhjes së fondeve, ju mund ta vendosni [në Facebook](#) dhe GAF gjithashtu do ta postojë në faqen e saj të internetit dhe faqen e Facebook.
2. Dikush nga organizata juaj duhet të krijojë një Facebook Fundraiser, GAF nuk do ta bëjë këtë për ju, por ne do të ju ndihmojmë për të promovuar mbledhjen e fondeve - sigurohuni që të keni të paktën dy persona (Stafin, Anëtarët e Bordit) të renditur si organizatorë të mbledhjes së fondeve sepse një fushatë për mbledhje të suksesshme fondesh nuk mund të bëhet nga një person.

3. Vendosni një qëllim real real - në përgjithësi, është më mirë të filloni me një qëllim modest financiar që mund ta rritni gradualisht kur të arrihen qëllimet financiare primare.
4. Shumica e mbledhësve të fondeve zgjasin për një periudhë prej 2-3 javësh, por kjo varet nga organizata në konsultim me GAF.
5. Sigurohuni që mbledhja e fondeve tuaja të jetë atraktive për njerëzit që mund të përdorin laptopë ose kompjuterë desktop, por edhe për njerëzit që përdorin kryesisht pajisje mobile, gjithashtu, pasi dhurimet bëhen gjithnjë e më shumë në pajisjet mobile si telefonë celular etj.

Mesazhi i fushatës suaj

1. Shkruani një mesazh të shkurtër dhe të qartë për kauzën tuaj që tërheq vëmendjen e zemrave dhe mendjeve të donatorëve të mundshëm në mënyrë që ata të kuptojnë se çfarë bën organizata juaj në 20-30 sekonda - postimi juaj i parë duhet të jetë në anglisht dhe shqip dhe jo më shumë se 200 fjalë.
2. Sigurohuni që fushata e juaj e mbledhjes së fondeve të jetë e orientuar drejt veprimit dhe e përqendruar në një aktivitet, program ose projekt specifik që organizata juaj planifikon të bëjë, dhe jo vetëm mbledhje e përgjithshme e fondeve për organizatën tuaj.
3. Sigurohuni që postimi juaj i parë nuk është tepër specifik por që pasqyron temën e përgjithshme të asaj që bën organizata juaj - për shembull, mos postoni për një person ose një ngjarje - të jetë më specifike dhe mesazhet personale mund të postohen në postimet e mëvonshme të mbledhjes së fondeve.
4. Përdorni një foto ose imazh që tregon punën e organizatës suaj dhe e cila është pozitive dhe e fuqishme dhe do t'i bëjë njerëzit të dëshirojnë të dhurojnë.
5. Merrni parasysh infografikat që ndërthurin imazhe teksti dhe imazhesh për të krijuar një përvojë vizuale më të fuqishme.

Promovimi i fushatës suaj

1. Sigurohuni që të ndani fushatën e mbledhjes së fondeve sa më gjerësisht - hulumtoni dhe identifikoni individë, grupe dhe organizata që mendoni se do të interesoheshin për mbledhjen e fondeve, ndani atë me faqet dhe grupet përkatëse të Facebook, kërkoni miqtë dhe kolegët tuaj ta shpërndajnë atë. Shfrytëzoni fuqinë e mediave sociale duke shpërndarë dhe rishpërndarë në platforma të ndryshme.
2. Ftojini njerëzit të dhurojnë drejtpërdrejt në fushatën e juaj - veçanërisht ata njerëz që mendoni se kanë më shumë gjasa të dhurojnë - dhe kërkoni që ta ndajnë fushatën dhe të ftojnë të tjerët.

3. Postoni shpesh në fushatën e juaj dhe në lidhje me të - nuk keni pse të postoni çdo ditë, por çdo 2-3 ditë duhet të dërgoni përditësime dhe t'u kërkonti të tjerëve t'ju ndihmojnë gjithashtu për këtë - ndihmon shumë kur ka disa njerëz të ndryshëm të cilët postojnë dhe jo vetëm një person i vetëm
4. Ndani histori suksesi për punën që bëni gjatë fushatës suaj të mbledhjes së fondeve që janë personale dhe prekëse - këto histori do t'ju ndihmojnë të arrini donatorë të mundshëm dhe të personalizoni atë që bën organizata juaj duke bërë lidhje emocionale me donatorët.
5. Kërkojuni miqve, punonjësve dhe anëtarëve të bordit të organizatave tuaja që të promovojnë fushatën tuaj duke shpërndarë video, foto dhe artikuj që mund të ndani gjatë fushatës.
6. Promovoni dhe shpërndani fushatën e mbledhjes së fondeve tuaja në shumë mënyra të ndryshme dhe mos u mbështetni vetëm në Facebook dhe përdorni çfarëdo forme të mediave sociale që mendoni se funksionojnë më mirë për ju - tekste, email, buletine, Twitter, Instagram, LinkedIn.
7. Nëse merrni donacione të tjera të jashtme ose të mëdhaja për projektin tuaj, bëjeni atë publike sepse ju ndihmon që të grumbulloni më shumë para kur njerëzit shohin që individë ose organizata të tjera janë duke dhuruar.
8. Së fundmi, jini të vetëdijshëm se shpesh shumë donacione vijnë në fillim dhe në fund të fushatës së mbledhjes së fondeve, kështu që promovoni mbledhjen e fondeve tuaj pak më shumë përgjatë këtyre fazave.

Angazhimi i donatorëve tuaj

1. Gjatë gjithë fushatës suaj, falënderoni donatorët në komente, bëni like donacionet e tyre, dhe angazhohuni me ta pasi që ata do të jenë edhe donatorët tuaj të ardhshëm. Donatorët preferojnë dhe presin mirënjohje nga organizatat për kontributin e tyre, kështu që ju duhet ta përforconi këtë.
2. Pas përfundimit të fushatës, sigurohuni që të falënderoni dhe të shprehni mirënjohje për donatorët që ju mbështetën - falënderojini ata si një grup dhe individualisht, dhe njoftoni ata se sa para u mbledhën dhe si do të përdoren ata.
3. Këshilloni donatorët tuaj të cilët përdorin Facebook ose që nuk mund të dhurojnë atje që ata mund të dhurojnë në këtë [link duke përdorur Paypal](#) - megjithatë, ata gjithashtu duhet t'ju dërgojnë me email një kopje të faturës së tyre.
4. Nëse dëshironi të përdorni platforma të tjera të dhurimit përveç Facebook dhe faqes në internet të GAF diskutoni atë me ne dhe ne mund të shqyrtojmë së bashku mundësitë.
5. Donatorët ndihen më të sigurt dhe të frymëzuar kur kanë qasje në informacion. Sigurohuni që të publikoni shumën që keni mbledhur nga fushata në faqen tuaj të

internetit, duke qenë kështu një organizatë transparente; - mbajini ata të informuar për aktivitetet tuaja dhe si janë përdorur donacionet e tyre përmes postës elektronike, gazetave, faqes suaj të internetit dhe mediave sociale.

Materiale shtesë për lexim

[Five Tips For Facebook Fundraising Success](#)

[How Nonprofits Can Use Crowdfunding](#)

[Online Fundraising Guide](#)